



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2020, merr këtë

V E N D I M

- I. MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Zuka (Isuf) Beka.
- II.** Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 00694-7, Certifikata e pronësisë nr. P-71914050-00694-7, Zona kadastrale Matiçan, pjesë e parcelës kadastrale nr. 00715-1, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00715-1, Zona kadastrale Matiçan, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale nr. 00695-20, Zona kadastrale Matiçan, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00695-20, në pronësi të pronarit Zuka (Isuf) Beka.
- III.** Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Mati 1” në Prishtinë.
- IV.** Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V.** Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-464/01-33124/20, më 10.02.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

